



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:044042

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05630796

Ac.nr.1388/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Bllaca-Dula, kryetare, Halide Reka dhe Ylber Shurdhiqi, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.K nga fshati B....., Komuna e Sh....., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati N.B nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna e Shtërpçës – Drejtoria Komunale për Arsim, për kompensimin në emër të ushqimit për ditët e pranisë në punë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Shtërpçe, C.nr.41/2020 i datës 11.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. 25.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Shtërpçës – Drejtoria Komunale për Arsim, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Shtërpçe, C.nr.41/2020 i datës 11.12.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.41/2020 i datës 11.12.2020, ka vendosur:

I. Aprovohet në tërësi si e themeltë kërkesëpadia e paditëses B.K, nga fsh. B....., Komuna e Sh.....

II. Detyrohet e paditura Komuna e Shtërpçes, me seli në Shtërpçe, që paditëses t`ia kompensojë në emër të shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë për periudhën prej dt. 18.04.2017 deri me 31.03.2020, për 555 ditë pune, në shumë nga 2 euro për çdo ditë të punës, shumën e

përgjithshme 1.110 Euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e ushtrimit të padisë dt.10.04.2020, e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

III. Pjesërisht aprovohet kërkesa e paditëses për kompensimin e shpenzimeve të procedurës, ashtu që detyrohet e paditura që paditëses t'ia kompensojë 135 Euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë, ndërsa për pjesën e kërkuar të shpenzimeve procedurale deri në shumën 270 euro, në shumë prej 135 Euro, refuzohet e pathemeltë.”

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim për Gjykatën e Apelit që të aprovojë ankesën, ta prishë aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar paditësja, përmes të autorizuarit të saj, duke i kundërshtuar pretendimet ankimore të paditurës, me propozim që të refuzohet e pathemeltë ankesa e të paditurës dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit të saj, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi me datë 10.04.2020, kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija e paditëses dhe të detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguajë në emër të kompensimit për ushqim për ditët e pranisë në punë për periudhën 18.04.2017 e gjer më 31.03.2020, për 555 ditë të pranisë në punë, për secilën ditë nga 2 Euro, në shumë të përgjithshme prej 1110 Euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë, si dhe shpenzimet e procedurës, e më decidivisht sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, padinë bashkë me shkresat e lëndës, bashkë me aktvendimin për përgjigje në padi, ia ka dërguar të paditurës, për të dhënë përgjigje në padi, ku aktvendimin, bashkë me padinë dhe shkresat e lëndës e paditura i ka pranuar me dt. 16.11.2020 (gjë që vërtetohet nga fletëkthesa për dorëzim personal), por që nuk ka vepruar sipas aktvendimit të gjykatës, përkundër faktit që më aktvendim ka qenë e njoftuar e paditura edhe për pasojat ligjore të mosveprimit.

Gjykata e shkallës së parë, pasi që e paditura nuk ka dhënë përgjigje në padi, përkundër faktit që ka qenë e njoftuar për pasojat ligjore, pas shqyrtimit të provave në shkresat e lëndës, jashtë seancës ka marrë aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë/mosbindjes C.nr.41/2020, me dt. 11.12.2020, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 150 të LPK-së, sepse e paditura nuk ka dhënë përgjigje në padi, e as me parashtrësë nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit, themelësia e kërkesëpadisë buron nga faktet e cekura në padi dhe provat e bashkangjitura, si dhe faktet në të cilat bazohet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat të cilat paditësi i ka parashtruar, si dhe nuk bëhet fjalë për kërkesa me të cilat palët nuk mund të disponojnë lirisht, sipas nenit 3 të LPK-së. Tutje gjykata ka shtuar se nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, nga të cilat rezulton themelësia e kërkesëpadisë, konkretisht nga vërtetimet e lëshuara nga Shkolla e Mesme e Ulët “.....”, në fshati B....., Komuna Sh....., me nr..... e dt. 05.11.2020, u vërtetua se paditësja për periudhën kohore prej dt. 18.04.2017 deri me dt. 31.03.2020, ka pasur gjithsej 555 ditë të pranisë në punë, ndërsa lartësinë e kërkesëpadisë për të drejtën e ushqimit gjatë punës për ditët e pranisë në punë, gjykata e mbështeti në shumën nga 2 euro për secilën ditë të pranisë në punë, ku ia ka gjykuar shumën e tërësishme prej 1110 Euro, duke llogaritur nga 2 Euro për secilën ditë të pranisë në punë.

Për bazën juridike të kërkesëpadisë dhe lartësinë e saj, iu është referuar dispozitës së nenit 2.1.2, 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e datës 18.04.2017 e cila ka hyrë në fuqi menjëherë, neni 245 të LMD-së, lidhur me kamatën iu referua neni 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së dhe neni 150 të LPK-së. ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës e mbështeti në nenin 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së. Aktgjykimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm dhe në arsyetimin e aktgjykimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me faktet thelbësore, provat e shqyrtuara dhe zbatimin e të drejtës materiale.

Gjykata e Apelit nuk i pranoi pretendimet ankimore të palës ankuese se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika i) e lidhur me nenin 104 par. 1 dhe 150 par.1 dhe 3 të LPK-së, ku sipas nenit 104.1 të LPK-së, parashihet se: *“Dërgimi organeve shtetërore dhe personave juridik u bëhet duke iu dorëzuar shkresat personit të autorizuar për pranimin e tyre apo të punësuarit që gjendet në zyrën, gjegjësisht në lokalit e punës”*, e poashtu sipas nenit 182.2 pika i) parashihet se: *“Në qoftë se ndonjëherë nga palët me veprimin e paligjshëm, e sidomos me mosdhënien e mundësisë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë”*, për arsye se Komuna si organ shtetëror, e paditur, selinë e saj e ka në objektin administrativ të saj, në të cilin janë të gjithë punëtorët e saj, ku dorëzuesi i gjykatës, meqë nuk e ka takuar personin e autorizuar të saj, i njëjti ia ka dorëzuar personit të punësuar të saj, aktvendimin për përgjigje në padi bashkë me shkresat e lëndës, i cili gjendet në të njëjtin objekt/lokal të punës me punëtorin e autorizuar për pranimin e shkresave, e i cili ka qenë i detyruar që t'ia dorëzojë atij, në mënyrë që të protokollohet dhe të ndërmerren veprimet e

mëtejme në drejtim të dhënies së përgjigjes në padi, andaj edhe kjo gjykatë vlerëson se shkresa iu është dorëzuar të paditurës në mënyrë të rregullt, meqë e ka pranuar i punësuar i të paditurës, andaj kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka marrë aktgjykimin për shkak të padëgjueshmërisë/mosbindjes, konform nenit 150.1 pikat a), b), c) dhe par 2 të LPK-së, ngase janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore, se të paditurës i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për të dhënë përgjigje në padi, me datë 16.11.2020 (që vërtetohet nga fletë kthesa për dorëzim personal), nga faktet e treguara në padi del themelësia e kërkesëpadisë, faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht, si dhe nuk kemi të bëjmë me kërkesë me të cilën palët nuk mund të disponojnë lirisht nga neni 3 par. 3 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nuk e pranon pretendimin ankimor se kemi shkelje të dispozitës së nenit 150.3 të LPK-së, për faktin se nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, të cilat i vërtetojnë faktet e treguara në padi, konkretisht nga vërtetimi i Shkollës së Mesme të Ulët “.....”, në fshati B....., vërtetohen faktet se paditësja ka punuar në këtë shkollë dhe për periudhën kohore prej dt. 18.04.2017 deri më 31.03.2020, ka pasur gjithsej 555 ditë të pranisë në punë, ndërsa nuk është kontestues fakti se e paditura në shkollën ku paditësja është e punësuar nuk ka kushte të ofrimit të ushqimit në punë përmes restaurantit, kuzhinës apo ndonjë forme tjetër dhe sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë ndër të tjera parashihet edhe se: *“Vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë është 2 euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucione arsimore”*.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjykuar për kompensim të ushqimit gjatë punës për ditët e pranisë në punë, për arsye se: Me nenin 90 paragrafi 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet : a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) në nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 4 përcaktohet se: *“ Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*. Ndërsa nenin 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, është përcaktuar se: *“ Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të ushqimi për një ditë të pranisë në punë është 2 euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucione arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim për të bërë kompensimin”*. Andaj edhe për vlerën për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë për 555 ditë të punës, me të drejtë iu është njohur shuma prej 1110 €.

Sa i përket pretendimit ankimor të palës së paditur se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 nuk është nënshkruar nga e paditura dhe për këtë arsye nuk prodhon efekt

juridik për të njëjtën si punëdhënëse, nuk qëndron kjo për faktin se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, e cila është nënshkruar nga autoritetet kompetente, në rastin konkret nga Ministri i Arsimit dhe kryetari i SBASHK-ut, në nenin 2 par.1 pika 1.2 shprehimisht përcakton se *‘‘Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat – DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës’’*.

Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale të referuar për këtë çështje juridike kontestuese nga ka rrjedhë edhe përfundimi për themelësinë e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit e ka ekzaminuar aktgjykimin e atakuar në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, konform nenit 194 të LPK-së si dhe kjo gjykatë i mori parasysh të gjitha pretendimet tjera ankimore, por të cilat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe, se si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit vlerëson se kamata e gjykuar për pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë është në përputhje me nenin 382 të LPK-së, ndërsa shpenzimet procedurale janë në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike dhe në pajtim me dispozitat ligjore të LPK-së.

Nga të lart cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.1388/2021, me datë 25.04.2024

Kryetarja e kolegjit
Nora Bllaca-Dula, d.v.